

VENDIM
Nr.208, datë 25.2.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I
VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E RROGOZHINËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Rrogozhinës, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Masa e shpërblimit të pronarëve, për pasuritë pronë private, me sipërfaqe 3254 (tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) m², tokë/arë, që shpronësohen, është 1 792 954 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Rrogozhinës, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale do të përballohet nga bashkia e Rrogozhinës.

6. Afati i përfundimit të punimeve, në objektin “Zgjerimi i varrezave publike” të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Rrogozhinës. Regjistrimi i ri i pasurisë, 3254 (tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) m², tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Rrogozhinës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO
TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË**

RROGOZHINË

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqja në m ²	Çmimi në lekë	Vlera në lekë	N/K	Zona kadastrale
1	Rifat Kasa	760	551	418760	249/1	3235
2	Skënder Kasa	800	551	440800	249/2	3235
3	Beqir Kasa	578	551	318478	249/3	3235
4	Tahir Toska	1116	551	614916	216	3235
	SHUMA	3254		1792954		